VENDIM
Nr. 405, datë 13.5.2015

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 50, DATË 5.2.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR PARANDALIMIN DHE SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA E TË PLANIT TË VEPRIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 160/2014, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2015", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 7, të shkronjës "A", "Hyrje dhe të dhëna paraprake", të Strategjisë për Parandalimin dhe Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura e të planit të veprimit, miratuar me vendimin nr. 50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

"7/1. Në kuadër të Strategjisë për Parandalimin dhe Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura, do të trajtohen edhe kërkesat e paraqitura në institucionet buxhetore për shlyerjen e detyrimeve për vendime gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë pas datës 31.12.2013, por që procesi i gjykimit dhe vendimi i shkallës së parë të gjykimit është përpara datës 31 dhjetor 2013.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama